
AKT THEMELIMI

“S Playground” SHPK

1. Forma ligjore dhe emri i shoqërisë

Emri i shoqërisë do të jetë “**S Playground**” **SHPK**, nga këtu e më poshtë referuar edhe si “shoqëria”, e cila themelohet si një shoqëri tregtare në formën e “Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar” ose “SHPK”.

2. Ortakë të shoqërisë janë:

- “**KASTRATI**” **SHPK** me nr. NUIS M21612025K me seli në adresën: Njësia Bashkiake Nr.5, Zona Kadastrale 8160, Sheshi “Italia”, Mak Albania Hotel, Tiranë, Shqipëri, zotërues i 100% të kapitalit të shoqërisë;

3. Objekti i veprimtarisë

Objekti i veprimtarisë do të jetë:

Kryerja e aktiviteteve te argetimit dhe relaksit per grupmosha te ndryshme si; bilardo, ping pong, tenis etj, lojra elektronike per femije dhe te rritur, kafe – bar. Import-eksport, tregti me pakice dhe shumice te lodrave per femije, artikujve industriale etj. Tregti me shumice dhe pakice te artikujve ushqimore dhe industriale si dhe aktivitet ne fushen e ofrimit te sherbimit te instalimit, riparimit, montimit te lodrave per femije, te pajisjeve sportive etj si dhe kryerjen e çdo aktiviteti tjeter te nevojshem, ndihmes apo plotesues ne funksion te objektit kryesor te shoqerise.

Shoqëria mund të kryejë çfarëdo veprimtarie tjeter që lejohet nga legjislacioni në fuqi i Republikës së Shqipërisë.

Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë mund të ndryshohet ose shtohet me vendimin e Asamblesë së ortakëve.

4. Selia e shoqërisë

- Selia e Shoqërisë do të jetë në adresën: **Njësia Bashkiake Nr.5, Zona Kadastrale 8160, Sheshi “Italia”, Mak Albania Hotel, Tiranë, Shqipëri.**
- Shoqëria mund të hapë degë dhe/ose zyra përfaqësie, brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, si dhe mund të marrë pjesë në shoqëri të tjera shqiptare dhe/ose të huaja, që ekzistojnë ose do të krijohen në të ardhmen. Këto mund të krijohen ose mbyllen me një vendim të thjeshtë të administratorit.

5. Kohëzgjatja e shoqërisë

Afati i veprimtarisë së Shoqërisë është **i pacaktuar**. Ky afat fillon nga data e regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

6. Kapitali themeltar

- Kapitali themeltar i shoqërisë është ALL 1 000 000 (një milion leke).
- Kapitali përbëhet nga 1 (një) kuote me vlerë nominale ALL 1 000 000 (një milion leke) dhe zotërohet nga Ortakët e shoqërisë sipas pjesëmarrjeve në kapitalin e shoqërisë sa më sipër.

7. Organet vendimmarrëse të shoqërisë

Organet vendimmarrëse të shoqërisë janë:

- Asambleja e Ortakëve.
- Administratori.

8. Administratori

- Administratori emërohet për një mandat 5 (pesë) vjeçar. Ai zëvendësohet ose shkarkohet nga kjo detyrë me vendim të Asamblesë së Ortakëve. Mandati është i rinovueshëm. Administrator i parë i shoqërisë është: **Z. Enea Alinj, shtetas Shqiptar, i datëlindjes 14.11.1995, banues në Tiranë, e identifikuar nga pasaporta me nr. BA3076667 dhe nr. personal J51114028G.**

9. Likuidimi i shoqërisë


Në rast prishje të shoqërisë, likuidimi apo falimentimi, shoqëria do të likuidohet në përputhje me dispozitat në fuqi në legjislacionin shqiptar.

ORTAKËT E SHOQËRISË "S Playground" SHPK

"KASTRATI" SHPK

Përfaqësuar nga Z/Zj.

Eda Spahiu



Tiranë më **06.01.2025**